



PLANI VJETOR I PUNËS 2023

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Udhehoqje të Urbanizimit, Planifikimit dhe Mbrojtjes të Mjedisit



Numri i Dokumentit: 03 Më 05.01.23

Rahovec, Dhjetor 2022

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, paraqet planin vjetor të punës duke u bazuar në prioritet strategjike dhe të nevojave të qytetarve të komunës sonë. Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2023 është hartuar me kujdes të veçantë, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e zbatimit dhe përmbushjes së vizionit të qeverisë komunale.

Plani është i ndarë në katër periudha tre mujore.

Përkushtim i veçantë i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, do të jetë:

- Miratimi i Planit Zhvillimor të Komunës së Rahovecit;
- Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Sheshi qendror në Qytet.

Tremujori i parë

Në tremujorin e parë të vitit 2023, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjithë kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjorë siq janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, çerifikata të përdorimit. Poashtu, synojmë rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, lejeve mjedisore komunale dhe me kalimin e ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Kuvendin e Kosovës, do fillojmë me legalizimin e objekteve pa leje.

Gjatë kësaj periudhe poashtu planifikojmë:

- Zbatimin e Planit të Prokurimit për nisjen e procedurave të prokurimit në afatin e përcaktuar në plan;
- Mbajtjen e diskutimit publikë për Planin Zhvillimor të Komunës së Rahovecit;
- Miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Rahovecit;
- Mbajtjen e diskutimit publikë për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Përgatitjet për fillimin e punimeve në projekte kapitale.

Tremujori i dytë:

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjithë kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjorë siq janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, çerifikata të përdorimit.

Gjatë kësaj periudhe, planifikojmë:

- Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit;
- Përfundimin e objektit të Banimit Social;
- Mbikëqyrjen e projekteve kapitale për cilësinë e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projekteve.

Tremujori i tretë:

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjithë kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjorë siq janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, çerifikata të përdorimit.

Mbikëqyrjen e punimeve në projekte kapitale për cilësinë dhe ecurinë e tyre, me inxhinierë e komunës dhe mbikqyrës të jashtëm, duke kërkuar realizim sa më mirë të tyre.

Tremujori i katërt:

Fokusi në periudhën e fundit të vitit do të jetë: menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me menaxherët e kontratave. Prioritet do të jetë dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023.